

GJYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS, si gjykatë e shkallës së dytë, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Dean B. Pineles, si kryetar i trupit gjykues, Gjyqtari Rafet Haxhaj dhe Gjyqtari Vehbi Kashtanjeva, si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Oficerja Ligjore e EULEX-it Zane Ratniece, si proçesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit:

SZ, lindur më XX, në XX, vendbanimi Rruga XX;

Akuzuar sipas Aktakuzës PP. Nr.2967-3/2009, të datës 2 tetor 2009, siç është ndryshuar nga prokuroria gjatë gjykimit kryesor më datën 21 tetor 2010 dhe më datën 5 prill 2011; dhe

Me anë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, P. Nr. 1960/09, të datës 7 prill 2011 (që këtej e tutje '**Aktgjykimi**'), Gjykata e Shkallës së Parë:

KA HEDHUR POSHTË Akuzat 2, 6 dhe 8;

E KA LIRUAR të pandehurin nga

Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin, Neni 200 (2)

1) i Kodit Penal të Kosovës (KPK) (Pika 4); dhe

Marrja e Mitës, Neni 343 (1) i KPK (Pika 7); dhe

E ka shpallur të pandehurin FAJTOR për veprat:

Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin, Neni 200 (2)

1) i KPK-së (Pika 1), dhe e ka dënuar atë me gjashtë (6) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave në administratën publike apo shërbimin publik për tri (3) vjet;

Tentativë për Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin, Neni 20, 200 (2) 1) i KPK-së (Pika 3), pra të rikualifikuar nga akuza fillestare e Keqtrajtimit në Ushtrimin e Detyrave, Neni 164 (1) i KPK-së, dhe e ka dënuar atë me katër (4) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave në administratën publike apo shërbimin publik për tri (3) vjet;

Marrja e Mitës, Neni 343 (1) i KPK-së (Pika 5), dhe e ka dënuar atë me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave në administratën publike apo shërbimin publik për tri (3) vjet;

Keqtrajtim në Ushtrimin e Detyrave, Neni 164 (1) i KPK-së (Pika 9), e riklasifikuar nga akuza fillestare e Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare apo Autoritetit, Neni 339 (2), (1) i KPK-së, dhe dënuar me gjashtë (6) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave në administratën publike apo shërbimin publik për tri (3) vjet;

Keqtrajtim në Ushtrimin e Detyrave, Neni 164 (1) i KPK-së (Pika 10), dhe dënuar me katër (4) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave në administratën publike apo shërbimin publik për tri (3) vjet; dhe

E KA DËNUAR të pandehurin me dënimin unik prej dy (2) vjetësh e katër (4) muajsh burgim dhe me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave në administratën publike apo shërbimin publik për tri (3) vjet;

TANI, Gjykata e Shkallës së Dytë DUKE VEPRUAR sipas ankesës së dorëzuar nga avokati mbrojtës Bajram Tmava, ushtruar në emër të të pandehurit SZ, të datës 1 gusht 2011, të pranuar në Gjykatën e Shkallës së Parë më 9 gusht 2011 ('Ankesa'); dhe

PAS marrjes në konsideratë të mendimit të Prokurorit Publik të Qarkut Agron Qalaj, të datës 2 maj 2012, dorëzuar në Gjykatë më 4 maj 2012; dhe

PAS mbajtjes së seancës së trupit gjykues, të hapur për publikun, më datën 15 nëntor 2012, në praninë e të pandehurit SZ, avokatit të tij mbrojtës Bajram Tmava dhe Prokurorit Publik të Qarkut Abdylrahim Islami; dhe

PAS këshillim-votimit të mbajtur më 15 nëntor 2012 dhe më 3 dhjetor 2012; dhe

SIPAS Nenit 420 të Kodit të Proçedurës Penale të Kosovës (KPPK)

Shpall si në vijim

AKTGJYKIM

MBI BAZËN E ANKESËS

1. **PIKA 1**

Dënimi për **Pikën 1, Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin**, Neni 200 (2) 1) i KPK-së, që 'në vitin 2006, në Stacionin e Policisë në Obiliq, në pozitën e tij të komandantit të stacionit të policisë, duke abuzuar me kontrollin e tij mbi punonjësen MP, oficere policie në stacionin e sipërpërmendur, gjatë një takimi me të, ka kapur dorën e MP për qëllime seksuale dhe u përpoq që ta puthte atë në buzë, dhe arriti ta puthte atë në faqen e djathtë' ANULLOHET *ex officio*, në bazë të Nenit 389 4), 425 të KPPK-së, sepse ndjekja penale ishte e ndaluar në bazë të skadimit të periudhës së parashkrimit. Prandaj **Pika 1, Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin**, Neni 200 (2) 1) të KPK-së **HIDHET POSHTË**.

2. **PIKA 3**

Aktgjykimi për **Pikën 3, Tentativë për Abizim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin Zyrtar**, Nenet 20 dhe 200 (2) 1) KPK **MODIFIKOHET** *ex officio* sipas Neneve 424 (4), 426 (1) të KPPK-së. Gabimi i dukshëm në përdorimin e fjalëve në aktgjykim ‘maj ose qershor 2008’ modifikohet në ‘nëntor ose dhjetor 2008.’ Gjendja faktike tani lexon ‘sepse në nëntor ose në dhjetor të vitit 2008, në Stacionin e Policisë në Obiliq, në pozicionin e tij si komandant i Stacionit të Policisë së Obiliqit duke shpërdoruar kontrollin e tij mbi punonjësen VG, oficerë policie në stacionin e sipërpërmendur, gjatë një takimi me të ndërmerri një veprim të menjëhershëm duke e prekur atë në shpatull për qëllime seksuale dhe që ta puthte atë, por duke mos e përfunduar veprimin e tij’.

3. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Bajram Tmava **APROVOHET PJESËRISHT si në vijim:**

4. **PIKA 5**

Aktgjykimi për **Pikën 5, Marrja e Mitës**, Neni 343 (1) i KPK-së, **MODIFIKOHET** në bazë të Neneve 390 3), 420 (1) 4), 426 (1) të KPPK-së. I pandehuri **LIROHET nga Pika 5, Marrja e Mitës**, Neni 343 (1) i KPK-së, sepse nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ‘SZ në maj apo qershor të vitit 2008, në Obiliq, në kapacitetin e tij të komandantit të Stacionit të Policisë së Obiliqit dhe për këtë arsye si një person zyrtar, ka pranuar 500 euro nga BZ, me qëllim që të kryejë, brenda fushës së autoritetit të tij, një akt zyrtar të cilin ai nuk duhet ta kishte kryer – që të ndihmonte BZ që ta detyronte BK të largohej nga apartamenti që i përkiste BZ’.

5. **PIKA 9**

Aktgjykimi për **Pikën 9, Keqtrajtimi gjatë Ushtrimit të Detyrave**, Neni 164 (1) i KPK-së, **MODIFIKOHET** sipas Neneve 403 (2) 2), 424 (1), 426 (1) të KPPK-së. Dënimi **RIKLASIFIKOHET** sipas akuzës fillestare, **Shpërdorimi i Pozitës Zyrtare apo Autoritetit**, Neni 339 (1) i KPK-së, ‘sepse nga viti 2006 e deri në vitin 2009, në Stacionin e Policisë në Obiliq, i pandehuri ka shpërdoruar pozitën e tij zyrtare si komandant i Stacionit të Policisë

së Obiliqit, me qëllimin për t'i shkaktuar dëme psikologjike KH, oficere policie në stacionin e sipërpërmendur, duke i thënë asaj në disa raste 'ti s' di asgjë, ti nuk di të flasësh, je vetëm një gjë e qelbur'.

6. **DËNIMI**

Për shkak se Pika 1 është hedhur poshtë dhe i pandehuri SZ është liruar nga Pika 5, dënimi i përgjithshëm tani është katërmbëdhjetë (14) muaj burgim. Dënimi shtesë ai i ndalimit të ushtrimit të detyrave të administratës publike apo shërbimit publik, për secilën nga **PIKAT 3, 9 dhe 10 është MODIFIKUAR** në dy (2) vjet pas vuajtjes së dënimit me burgim.

Dënimi unik, sipas Neneve 71 (1), (2) 3), (3) të KPK-së është përcaktuar në dymbëdhjetë (12) muaj burgim, duke përlogaritur edhe periudhën kohore në të cilën i pandehuri ka qenë në paraburgim dhe arrest shtëpiak, nga data 27 gusht 2009 e deri më datën 5 janar 2010; dhe me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave të administratës publike apo shërbimit publik për dy (2) vjet pas vuajtjes së dënimit me burgim.

7. Ankesa e avokatit mbrojtës Bajram Tmava **HIDHET POSHTË** për pjesën e mbetur.

ARSYETIMI

I. **Historia Proçeduriale e çështjes.**

1. Më 24 gusht 2009, një raport penal fillestar u dërgua në Zyrën e Prokurorit Publik Komunal kundër të pandehurit SZ për kryerjen e veprave penale.
2. Më 27 gusht 2009, i pandehuri u arrestua dhe prokurori dorëzoi në Gjykatën Komunale të Prishtinës një kërkesë për vendosjen e paraburgimit ndaj të pandehurit. Kërkesa nuk u

aprovua dhe ndaj të pandehurit u vendos arresti shtëpiak, që do të përllongaritej që nga data e arrestimit.

3. Më 3 shtator 2009, në Gjykatën Komunale të Prishtinës, u dorëzua një Propozim-Akuzë, e cila u ndryshua me vepra të reja penale, më datën 9 shtator 2009. Më 24 shtator 2009, Gjyqtari i Konfirmimit të Aktakuzës ia ktheu Propozim-Akuzën prokurorit, duke theksuar se prokurori duhet të kryente një hetim të plotë dhe pastaj të ridorëzonte aktakuzën. Më 2 tetor 2009, prokurori e ridorëzoi aktakuzën, duke e akuzuar të pandehurin me dhjetë (10) Akuza.
4. Më 15 tetor 2009, me anë të vendimit KA. No. 274/09, Gjyqtari i Konfirmimit të Aktakuzës, Driton Muharremi e konfirmoi aktakuzën.
5. Më 29 tetor 2009, prokurori i EULEX-it iu drejtua Zyrës së Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, me një kërkesë e cila u mbështet edhe nga Kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës, letra e së cilës daton më 20 nëntor 2009.
6. Më 23 nëntor 2009, u mbajt një seancë në Gjykatën Komunale të Prishtinës nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it me qëllim që të vlerësohej nëse çështja duhej marrë nga Gjyqtarët e EULEX-it, dhe pas kësaj u morr një vendim që çështja t'i kalonte Gjyqtarëve të EULEX-it.
7. Më 18 tetor 2010, filloi gjykimi kryesor. Trupi gjykues fillimisht përbëhej nga Gjyqtari i EULEX-it Gianfranco Gallo, si kryetar dhe nga Gjyqtari i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll dhe Gjyqtarja Elmaze Fazliu, si anëtarë të trupit gjykues. Pas formaliteteve paraprake, filloi marrja në pyetje e dëshmitarëve.
8. Më 21 tetor 2010, gjatë seancës së gjykimit kryesor, prokurori e ndryshoi aktakuzën si në vijim: akuzat që kishin lidhje me Pikat 1 dhe 3 të aktakuzës, fillimisht të klasifikuara si **Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin**, Neni 200(1)1) i KPK-së (akt seksual) u ndryshuan në **Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin**,

Autoritetin apo Profesionin, Neni 200 (2) 1) i KPK-së (prekje). Akuza që kishte lidhje me Pikën 10 të aktakuzës, fillimisht e klasifikuar si **Shpërdorimi i Pozicionit Zyrtar apo Autoritetit, Neni 339 i KPK-së**, është riklasifikuar si **Keqtrajtim në Ushtrimin e Detyrave**, Neni 164 (1) i KPK-së.

9. Gjatë seancës së datës 5 prill 2011, prokurori tërhoqi Pikat 2, 6 dhe 8 të aktakuzës, ndërsa akuza që kishte lidhje me Pikën 3 të aktakuzës u riklasifikua nga akuza fillestare e **Keqtrajtimit gjatë Ushtrimit të Detyrave, Neni 164 (1) i KPK-së** në **Tentativë Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozitën Zyrtare**, Neni 200 (2) 1) i KPK-së.

II. Ankesa e mbrojtjes. Pranueshmëria. Juridiksioni.

10. Avokati mbrojtës Bajram Tmava dorëzoi një ankesë në emër të të pandehurit SZ, që mban datën 1 gusht 2011, pranuar në Gjykatën e Shkallës së Parë më datën 9 gusht 2011. Në bazë të Nenit 398 (1) të KPPK-së, ankesa kundër një aktgjykimi të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë mund të dorëzohet brënda pesëmbëdhjetë (15) ditësh që nga dita e marrjes së kopjes së aktgjykimit. Megjithatë, trupi gjykues nuk është në gjendje të përcaktojë datën në të cilën i pandehuri apo avokati mbrojtës e kanë pranuar aktgjykimin. Nuk ka fletë-dorëzimi në dosjen e lëndës të bashkëngjitura në aktgjykim që të dëshmojnë dorëzimin e tij tek i pandehuri dhe avokati mbrojtës Bajram Tmava. Megjithatë, dosja përmban një aktvendim të marrë nga Kryetari i Trupit Gjykues, Gjyqtarit të EULEX-it Gianfranco Gallo duke vepruar në Shkallën e Parë, të datës 11 nëntor 2011, dhe i lëshuar në përputhje me Nenin 407 (2) të KPPK-së. Në bazë të aktvendimit të fjalë ankesa do të konsiderohet si e dorëzuar me kohë në mungesë të fletë-dorëzimit.
11. Trupi gjykues pajtohet me përfundimet e Kryetarit të Trupit Gjykues, Gjyqtarit të EULEX-it, Gianfranco Gallo. Sipas kësaj, nuk ka baza që gjykata aktuale ta refuzojë ankesën si të

vonuar, në bazë të Nenit 421 të KPPK-së. Ankesa konsiderohet të jetë dorëzuar brenda afatit dhe për këtë arsye ankesa do të shqyrtohet lidhur me meritat e saj.

12. Në bazë të Nenit 23 2) të KPPK-së, gjykata aktuale është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me ankesën.

III. Bazat e sfidimit në Ankesë. Përgjigjja e Prokurorisë.

13. Avokati mbrojtës Bajram Tmava dorëzoi një ankesë të shumëfishtë, duke deklaruar 'shkelje absolute'¹ të procedurës penale, shkelje esenciale të të procedurës penale dhe vërtetimin e gabuar e të paplotë të gjendjes faktike. Ai kërkon që Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të anulohet dhe çështja të kthehet për rigjykim. Listuar menjëherë më poshtë janë argumentet e avokatit mbrojtës të paraqitura në ankesën e tij me shkrim:

A. 'Shkelje Absolute' (të trajtuara nga Trupi Gjykoes si 'shkelje substanciale' sipas Nenit 403 të KPPK-së):

- 1) Pranimin si prova të deklaratave të dhëna në polici nga BK dhe NZ pa pasur mundësinë e marrjes në pyetje nga pala e kundërt, në kundërshtim me Nenin 156 (2) të KPPK-së, që çon kështu në shkeljen e Nenit 403 (1) 8) të KPPK-së. Ky aludim lidhet me **Pikën 5, Marrjen e Mitës**. Kjo çështje shqyrtohet në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, në faqen nr. 25.
- 2) Rikualifikimi i **Pikës 9** nga një shkelje në kundërshtim me Nenin 339 (1) të KPPK-së, **Shpërdorimi i Pozitës Zyrtare apo Autoritetit**, me ndëshkimin maksimal të një (1)

¹KPPK-ja nuk e përmban termin 'shkelje absolute' të procedurës penale. Në vend të kësaj, KPPK-ja e kufizon veten në 'shkeljet substanciale', sipas Nenit 403 të KPPK-së. Gjykata do të presupozojë që avokati mbrojtës synon që të gjitha 'shkeljet absolute' të jenë 'shkelje substanciale'. Është e mundur që avokati mbrojtës e ka përdorur termin 'shkelje absolute' thjeshtë për të theksuar seriozitetin e këtyre shkeljeve të aluduara.

viti burgim, në një shkelje në kundërshtim me Nenin 164 (1), **Keqtrajtim në Ushtrimin e Detyrave**, me ndëshkimin maksimal të tri (3) vjetëve burgim. Ankesa deklaron se kjo çon në shkelje të Nenit 403 (1) 10) të KPPK-së, sepse një shkelje sipas Nenit 164 (1) të KPK-së e ka tejkaluar fushën e akuzës fillestare në dëm të të pandehurit. Po ashtu, rikualifikimi ka ndodhur vetëm pas përfundimit të gjykimit kryesor dhe i pandehuri nuk ka pasur mundësi adekuate për t'u mbrojtur.² Rikualifikimi është shqyrtuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, në faqet nr. 33 deri në 34.

B. Shkeljet substanciale:

- 1) Kallëzimi penal është dorëzuar pa kryerjen e ndonjë hetimi dhe aktakuza është dorëzuar brenda tri (3) ditësh pa kryerjen e ndonjë hetimi, siç është theksuar në prejardhjen procedurale më sipër. Avokati mbrojtës debaton se prokurori duhet të dorëzojë aktakuzën vetëm atëherë kur ai/ajo është i kënaqur se provat janë të mjaftueshme sipas Nenit 304 (1) të KPPK-së. Kjo çështje nuk është shqyrtuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.
- 2) Kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë ka pranuar prova të reja në fillim të gjykimit kryesor, në vend që të ndiqte rradhën e aprovuar. Provat e reja përfshinin dokumente të shumta të dorëzuara nga MP dhe KB, dëshmitarët që ankohen, përkatësisht për Pikat 1 dhe 10, siç janë listuar në faqen nr. 7 të Aktgjykimit Gjykatës së Shkallës së Parë. Kjo çështje nuk është shqyrtuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Megjithatë, çështja është diskutuar në procesverbalin e gjykimit kryesor të datës 18 tetor 2010, në faqet nga 7 deri në 9.

²Pika 10, e cila fillimisht e akuzonte të pandehurin për shkeljen nën Nenin 339 (1) të KPK-së lidhur me një Palë tjetër të Lënduar, është ndryshuar herët në gjykimin kryesor, me një shkelje nën Nenin 164 (1) të KPK-së dhe kjo nuk është sfiduar në ankesë.

- 3) Palët e Lënduara duhet të ishin marrë në pyetje si dëshmitarë pa praninë e palëve të tjera të lënduara, sipas Nenit 164 (1) të KPPK-së. Kjo çështje është diskutuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, në faqen nr. 36.
- 4) Marrje në pyetje në formën jo të duhur kryer nga kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë, gjë që ka çuar në të qëniet e trupit gjykues të anshëm. Kjo vështje nuk është diskutuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.
- 5) I pandehuri nuk u lejua të mos merrte pjesë në seanca të caktuara duke pasur parasysh arsyet shëndetësore, seanca këto gjatë të cilave dha dëshmi BZ lidhur me **Pikën 5**. Mbrojtja kundërshtoi. Pastaj, avokati mbrojtës Bajram Tmava doli nga salla e gjyimit dhe refuzoi të bënte pyetje, duke deklaruar se klienti i tij ishte shumë i sëmurë për ta ndjekur procedurën (*shih* procesverbalin e gjyimit kryesor, të datës 17 dhjetor 2010). Gjatë seancës tjetër, asaj të datës 21 janar 2011, avokati mbrojtës Bajram Tmava kërkoi të rithirrej dëshmitari për t'u marrë në pyetje, kërkesë kjo që u refuzua. Kjo çështje është diskutuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, në faqen nr. 24.

C. Vërtetimi i gabuar dhe i paplotë i gjendjes faktike:

- 1) Nuk ka asnjë shtjellim apo shtjellim të gabuar të dëshmive që shkonin në favor të dëshmitarëve të mbrojtjes, ose shpjegime të të pandehurit lidhur me motivet e mundshme të palëve të lënduara, apo ndonjë mohim të të pandehurit lidhur me ndonjë veprim të gabuar.
- 2) Kontradikta të brendshme në dëshmitë e secili dëshmitar të prokurorisë, duke përfshirë secilën palë të lënduar, dhe këto kontradikta nuk u eliminuan me anë të përballjes.
- 3) Kontradikta në dëshmitë mes palëve të lënduara.

- 4) Kontradikta mes deklaratave me shkrim të palëve të lënduara dhe dëshmive të tyre të dhëna gjatë gjykimit kryesor.
 - 5) Dëshmitë e KH dhe KB, edhe po t'i marrim parasysh drejtëpërdrejtë, nuk përbëjnë ndonjë vepër penale nën Nenin 164 (1) të KPK-së (Pikat 9 dhe 10).
 - 6) Kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Shkallës së Parë e mori përsipër marrjen në pyetje dhe i shtrëngoi dëshmitarët të jepnin dëshmi inkriminuese.
 - 7) Vepra penale e Tentativës së Abuzimit Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin (Pika 3) thuhet të ketë ndodhur në periudhën maj-qershor 2008, ndërsa pala e lënduar nuk ishte transferuar në departamentin e të pandehurit deri më 2korrik 2008.
 - 8) Dëshmia e BZ është e paqëndrueshme në brendësi dhe është e paqëndrueshme edhe me dëshminë e AK (Pika 5).
 - 9) Nuk ka pasur ndonjë shpjegim të arsyeshëm të faktit që nuk ka pasur ndonjë gjurmë të parave që aludohet se janë transferuar tek gruaja e të pandehurit nga Uestern Union (Pika 5).
 - 10) Rrëmbimi gjoja fallco i aluduar i KB duhet të ishte shtjelluar lidhur me Pikën 10.
 - 11) Trupi gjykues i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk i ka dhënë besim dëshmisë së të pandehurit gjatë gjykimit kryesor dhe as asaj të mbrojtjes gjatë fjalës përfundimtare.
14. Në përgjigje të ankesës prokuroria dorëzoi propozimet e saj, të datës 4 maj 2012, që janë marrë nga gjykata më 4 maj 2012. Prokuroria nuk iu përgjigj argumenteve të ngritura nga

avokati mbrojtës në ankesë, por në fakt vetëm me një fjali kërkoi që ankesa të refuzohet dhe të mbetet në fuqi Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë.

15. Në seancën e trupi gjykues të datës 15 nëntor 2012, Prokurori Publik i Qarkut, Abdylrahim Islami mbeti pranë propozimit të prokurorisë, të datës 4 maj 2012. Përveç kësaj, prokurori deklaroi se në rast se provat nuk dëshmojnë lidhur me ndonjë transferim të fondeve përmes Uestern Unionit, siç dëshmohet nga dëshmitari lidhur me Pikën 5, duket se akuza për Marrjen e Mitës nuk mund të qëndrojë.

IV. Përfundimet e Gjykatës.

A. Konsideratat paraprake.

16. Që në fillim trupi gjykues vë re se disa nga argumentet e avokatit mbrojtës janë të natyrës së përgjithshme dhe lidhen me mënyrën me të cilën kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Shkallës së Parë e menaxhoi gjykimin kryesor (p.sh. anshmëria, marrja në pyetje në mënyrën jo të duhur). Argumente të tjera lidhen me pikat e veçanta të aktakuzës, të cilat trupi gjykues do t'i adresojë në fillim. Megjithatë, përpara se të bëhet kjo, trupi gjykues do të adresojë *ex officio* çështjen nëse ligji penal është shkelur në dëm të të pandehurit, sipas Nenit 415 (1) 4) të KPPK-së. Më specifikisht, nëse ndjekja penale e Pikës 1dhe lëshimi i dënimit ndaloheshin nga periodha e parashkrimit, sipas Nenit 404 3) të KPPK-së.

B. PIKA 1: Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin. Periudha e parashkrimit.

17. Aktakuza në Pikën 1 fillimisht e akuzon të pandehurin me një veprë penale në kundërshtim me Nenin 200 **(1)** 1) të KPK-së, Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin (kryerja e aktit seksual). Kjo veprë penale mban mbi vete një ndëshkim prej pesë (5) vjetësh burgim. Akuzë u ndryshua nga prokurori më datën 21 tetor 2010, pak pas fillimit të gjykimit kryesor në Gjykatën e Shkallës së Parë, në një veprë penale në kundërshtim me Nenin 200 **(2)** 1), Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin (prekja). Kjo veprë penale mban mbi vete një ndëshkim me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet.
18. Sipas Nenit 90 (1) të KPK-së, ndjekja penale mund të mos fillojë pasi ka kaluar një periudhë e caktuar kohore, në varësi të ndëshkimit të veprës penale të caktuar. Në bazë të Nenit 90 (1) 5), periudha prej tri (3) vjetësh e parashkrimit, e përlllogaritur që nga data e kryerjes së veprës penale deri në fillimin e ndjekjes penale, është paraparë kur vepra penale ndëshkohet me burgim për më shumë se një (1) vit por jo më shumë se tri (3) vjet. Ky kufizim aplikohet në një shkelje të Nenit 200 **(2)** 1), meqë ndëshkimi maksimal është tri (3) vjet.
19. Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë e ka shpallur të pandehurin fajtor për Pikën 1 të aktakuzës, siç është ndryshuar, që është kryerja e veprës penale nën Nenin 200 (2) 1) të KPK-së, Abuzimi Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin apo Profesionin (prekja). Aktgjykimi thotë që vepra penale ndodhi 'në vitin 2006' pa dhënë ndonjë specifikë tjetër. Dëshmia e dëshmitarit ankues gjatë gjykimit kryesor ishte e tillë që ngjarja kishte ndodhur 'diku nga mesi i vitit 2006' (*shih* procesverbalin e gjykimit kryesor, të datës 18 tetor 2010, faqe nr. 15). Trupi gjykues nuk ka qenë në gjendje të gjejë ndonjë provë shtesë e cila do të mund të përcaktonte një datë më të saktë.
20. Siç është shënuar në prejardhjen historike më sipër, kallëzimi penal është dorëzuar në prokurori më datën 24 gusht 2009, duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve të siguruara më herët në gusht të vitit 2009. Trupi gjykues beson se kjo është data e duhur për të përcaktuar se kur kishte filluar procedura penale. (I pandehuri u arrestua më datën

27 gusht 2009 dhe Propozim-Akuza u dorëzua më datën 3 shtator 2009.) Çështja që ngrihet është nëse periodha e parashkrimit aplikohet në këtë rast të veçantë.

21. Nëse fraza 'në mes të vitit 2006' interpretohet gjerësisht, mund të përfshijë muajin gusht të vitit 2006. Megjithatë, një interpretim më i ngushtë mund të sugjerojë të kundërtën. Prandaj, nuk mund të arrihet në përfundimin e sigurt nëse periodha tri (3) vjeçare e parashkrimit ka skaduar apo jo.
22. Po ashtu, duhet të përcaktohet nëse ka pasur ndonjë ndërprerje të kësaj periodhe. Sipas Nenit 91 (4) të KPK-së, periodha e parashkrimit ndërpritet nëse kryesi i veprës penale kryen edhe një vepër tjetër penale 'të barabartë ose më të rëndë' përpara skadimit të periodhës së parashkrimit. Këtu, i pandehuri është dënuar edhe për disa vepra të tjera të cilat kanë ndodhur përpara periodhës së skadimit të tri (3) vjetëve të parashkrimit që aplikohet për Pikën 1, vetëm njëra prej të cilave siguron një ndëshkim më të madh, dhe kjo është Marrja e Mitës, Pika 5, që mban mbi vete një ndëshkim maksimal prej pesë (5) vjetësh. Megjithatë, siç është diskutuar edhe më poshtë, trupi gjykues ka përcaktuar se nuk ka prova të mjaftueshme që ky dënim të qëndrojë, kështu që ai nuk mund të merret parasysh për qëllimet e periodhës së parashkrimit.
23. I pandehuri është dënuar po ashtu edhe për veprën penale të Tentativës për Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin Zyrtar, Neni 20 dhe Neni 200 (2) 1) i KPK-së, në Pikën 3. Një Tentativë do të ndëshkohet jo më shumë se tri të katërtat e ndëshkimit maksimal për vetë veprën penale, sipas Nenit 20 (3) dhe Nenit 65 (2) që në rastin aktual është tri të katërtat e tri (3) vjetëve. Sigurisht, kjo vepër penale nuk është 'e barabartë apo më e rëndë' se sa vepra penale e përfunduar.

24. Vepra penale e mbetur për të cilën është dënuar i pandehuri, përfshin një shkelje të Nenit 164 (1) të KPK-së, Keqtrajtimi gjatë Ushtrimit të Detyrave, Pika 10.³ Kjo vepër penal mban mbi vete ndëshkimin maksimal prej tri (3) muajsh e deri në tri (3) vjet burgim. Kështu që, çështja qëndron në atë që, vepra penale nën Nenin 164 (1) është 'e barabartë apo më e rëndë' se sa vepra penale nën Nenin 200 (2). Ndëshkimi maksimal është i njëjtë për të dyja veprat – tri (3) vjet burgim. Por vepra nën Nenin 164 (1) mban mbi vete një ndëshkim më të shkurtër – tri (3) muaj burgim –se sa minimumi i ndëshkimit për veprën nën Nenin 200 (2) të gjashtë (6) muajve burgim.
25. Për të vendosur nëse i pandehuri përfiton nga periudha e parashkrimit, trupi gjykues udhëhiqet nga dispozitat e Nenit 3 (2) të KPPK-së, që sigurojnë se '[d]yshimet lidhur me ekzistencën e fakteve relevante për çështjen apo dyshimet lidhur me zbatimin e një dispozite të caktuar të ligjit penal do të interpretohen në favor të të pandehurit dhe të të drejtave të tij apo të saj sipas Kodit aktual'. Prandaj, meqë ekzistojnë si dyshimet faktike edhe ato ligjore, trupi gjykues udhëhiqet pashmangshmërisht drejt përfundimit se dënimi për Pikën 1 nuk mund të qëndrojë për shkak të të gjitha dyshimeve të tilla, siç janë diskutuar më sipër, duhet të interpretohen në favor të të pandehurit.
26. Trupi gjykues do të adresojë tani argumentet që ka ngritur avokati mbrojtës lidhur me pikat e veçanta të akuzës.

C. PIKA 3: Tentativë për Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin Zyrtar.

27. Duke iu kthyer fillimisht Pikës 3, Tentativës për Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin Zyrtar, nën Nenin 20, 200 (2) 1) të KPK-së. Avokati mbrojtës debaton se Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë e ka shpallur të pandehurin fajtor për kryerjen e

³Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë e ka shpallur të pandehurin po ashtu fajtor edhe për një vepër penale nën Nenin 164 (1) të KPK-së, për Pikën 9, pro trupi gjykues aktual e ka rikualifikuar atë vepër sipas Nenit 339 (1), sic ka qenë në aktakuzën fillestare, dhe vepra sipas Nenit 339 (1) mban mbi vete ndëshkimin prej një (1) viti burgim.

kësaj veprë penale në periudhën maj-qershor të vitit 2008, në Stacionin e Policisë në Obiliq, ndërsa viktimë e supozuar VG nuk ishte transferuar në Stacionin e Policisë në Obiliq deri më 2 korrik 2008.

28. Me respekt ndaj argumentit të mësipërm të avokatit mbrojtës, trupi gjykues vë re se procesverbali i gjykimit kryesor tregon ekskluzivisht se vepra penale ka ndodhur pas datës 2 korrik 2008, dhe se Gjykata e Shkallës së Parë thjeshtë e ka tejkaluar këtë ose ka bërë një gabim ortografik në aktgjykimin e saj.
29. Në veçanti, VG është marrë në pyetje nga prokurori gjatë gjykimit kryesor më datën 21 tetor 2010. Ai kërkoi të dinte prej saj ditën kur ajo ishte kthyer në punë pas lejes së shtatzanisë. VG u përgjigj si në vijim:

‘Ishte maj apo qershor i vitit 2008, kur jam kthyer nga leja e shtatzanisë. Fillimisht kam punuar me turne të shkurtra. **Pas rreth gjashtë muajsh** [vihet theksi] kjo duhet të kishte përfunduar dhe unë duhet të isha kthyer në punë sipas rutinës sime normale. Dhe një javë përpara se të fillonte ndërrimi unë shkova në zyrën e tij. Unë nuk e di nëse ai më ftoi mua apo nëse shkova vetë, por kjo kishte të bënte me me orarin e ri të punës dhe pastaj unë do të bëja propozimin lidhur me turnin.’

Ishte në këtë takim kur ndodhi vepra.

30. Pjesa e dëshmisë së dëshmitares ankuese që është theksuar më sipër - ‘pas rreth gjashtë muajsh’ –tregon qartësisht se nuk ishte periudha maj-qershor e vitit 2008 kur ka ndodhur vepra, por ka qenë rreth gjashtë (6) muaj më vonë. Dhe nuk ka prova të tjera lidhur me këtë pikë përveç dëshmisë së VG. Prandaj, Gjykata e Shkallës së Parë ka bërë një gabim të përcaktuar të gjendjes faktike sipas Nenit 405 (2) të KPPK-së, në atë që ka përcaktuar një fakt material pasaktësisht, p.sh. datën e veprës penale. Data është materiale në këtë

çështje sepse i pandehuri ka deklaruar se viktima nuk ka qenë duke punuar në stacion gjatë asaj periudhe kohore.

31. Sipas kësaj, dispozitat e Nenit 424të KPPK-së na ndihmojnë. Paragrafi (1) i Nenit 424 *inter alia* thotë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë do të anulohet dhe çështja do të kthehet për rigjykim nëse ekziston një përcaktim i gabuar i gjendjes faktike. Megjithatë, kjo aplikohet vetëm atëherë kur një gjykim i ri kryesor është 'i nevojshëm' për të korrigjuar gjendjen faktike. Dhe ky nuk është rasti këtu.
32. Siç është shënuar më sipër, është e qartë që vepra penale ka ndodhur rreth gjashtë (6) muaj pas majit apo qershorit të vitit 2008. Dëshmia kritike lidhur me këtë - 'pas rreth gjashtë muajsh' – vjen në fjalinë menjëherë pas referencës së muajve maj apo qershor të vitit 2008. Në rastin më të keq, data e specifikuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë është thjeshtë një gabim nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, ose thjeshtë madje edhe një gabim ortografik. Gabimi mund të korrigjohet thjeshtë duke modifikuar Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë duke zëvendësuar datën e saktë – nëntor apo dhjetor i vitit 2008–në vend të datës së gabuar. Të urdhërohet një rigjykim për të korrigjuar një gabim të dukshëm kjo do të krijonte një absurditet ligjor që duhet shmangur.
33. Lidhur me aplikimin e Nenit 424 (4) dhe Nenit 426 (1) të KPPK-së, trupi gjykues duhet të marrë parasysh, po ashtu, një nga parimet themelore të procedurës penale–një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Koha e arsyeshme e garantuar është përcaktuar në Nenin 5 (1) dhe (2) të KPPK-së, si edhe në Nenin 31 (2) të Kushtetutës së Kosovës. Në bazë të Nenit 22 (2) dhe Nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, kjo garanci duhet aplikuar në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Garantimi i kohës së arsyeshme 'nënvizon rëndësinë e vënies në vend të drejtësisë **pa vonesa** të cilat mund të rrezikojnë **efektshmërinë** dhe **besueshmërinë**' e saj [*e theksuar*] (GJEDNJ, H v. Francës, 24 tetor 1989, par. 58). Qëllimi i kërkesës së kohës së arsyeshme është në këtë mënyrë të garantohet që brenda një kohe të arsyeshme dhe me anë të një

vendimi gjyqësor, përfundon një pasiguri në të cilën e gjen veten dikush lidhur me një akuzë penale ndaj tij apo saj. Kjo shkon në interes të vetë personit në fjalë, si edhe të vetë sigurisë ligjore.

34. Nën dritën e këtyre që u thanë më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se urdhërimi i një rigjykimi do të krijonte një panevojshmëri dhe një vonesë të kotë në procedurë. Rigjykimi nuk është i nevojshëm sepse dëshmia e VG është marrë tashmë nga Gjykata e Shkallës së Parë. Ajo dëshmi, siç është konsideruar më sipër, tregon qartësisht kohën e veprës penale—nëntor apo dhjetor të vitit 2008. Duke marrë në konsideratë garancinë e kohës së arsyeshme, gabimi në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë lidhur me datën e veprës penale, është modifikuar nga trupi gjykues, duke u bazuar në Nenin 424 (4) dhe në Nenin 426 (1) të KPPK-së.
35. Prandaj, argumenti i avokatit mbrojtës refuzohet.

D. PIKA 5: Marrja e Mitës.

36. Avokati mbrojtës se sfidon Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë lidhur me Pikën 5, Marrjen e Mitës, Neni 343 (1) i KPK-së, në disa baza: që deklaratat me shkrim të BK dhe NZ janë pranuar gabimisht, në kundërshtim me Nenet 156 (2), 403 (1) 8) të KPPK-së; që dëshmia e BZ është e paqëndrueshme në vetvete; që nuk ka asnjë shpjegim të arsyeshëm për faktin që nuk ka asnjë gjurmë të transferimit të aluduar të parave tek gruaja e të pandehurit përmes Uestern Unionit; se i pandehuri ka qenë i sëmure gjatë dëshmisë së BZ dhe se ai nuk është lejuar të largohet; dhe se Gjykata e Shkallës së Parë e ka refuzuar kërkesën e avokatit mbrojtës për ta rithirrur BZ për marrjen në pyetje nga mbrojtja pasi i pandehuri e ka marrë veten.

37. Trupi gjykues është bindur nga argumentet e avokatit mbrojtës deri më tani për sa ato lidhen me pamjaftueshmërinë e provave.
38. Gjykata e Shkallës së Parë në aktgjykimin e saj e ka shpallur të pandehurin fajtor për marrjen e mitës prej 500 Eurosh nga BZ, me qëllim që të kryejë, brenda fushës së autoritetit të tij, një akt zyrtar të cilin ai nuk duhet ta kryejë, që është, nxjerrja nga banesa e një uzurpuesi të pronës nga apartamenti i BZ. Ky përfundim bazohet kryesisht nga dëshmia e BZ dhënë gjatë gjykimit kryesor, i cili ka deklaruar se në maj apo qershor të vitit 2008, ai i ka paguar të pandehurit një rryshfet prej 500 Eurosh, të cilin ai e dërgoi përmes Uestern Unionit në llogarinë bankare të gruas së të pandehurit.
39. Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë bazohet po ashtu pjesërisht edhe në dëshminë e dhënë në polici nga NZ, që nuk ka pasur mundësi të dëshmojë në gjykimin kryesor.⁴ Dëshmia nuk ka qenë objekt i marrjes në pyetje nga ana e kundërt, por është pranuar sipas Nenit 368 (1) 1) të KPPK-së, pas kundërshtimeve të avokatit mbrojtës. Gjykata e Shkallës së Parë ka shpjeguar se ajo është përdorur për qëllimet e mbështetjes. Deklarata e NZ thoshte se (NZ) dhe BZ kërkuan ndihmën e të pandehurit për të nxjerrë një person nga apartamenti i BZ, që e kishte uzurpuar atë në mënyrë të paligjshme, dhe se BZ dha të pandehurit 2000 Euro për këtë qëllim.
40. Është zbuluar nga të dhënat financiare, të urdhëruara nga Gjykata e Shkallës së Parë, se nuk ka asnjë të dhënë të një transferte të një transaksioni të tillë të Uestern Unionit dhe se nuk ka pasur depozitë në llogarinë bankare të gruas së të pandehurit gjatë periudhës relevante. Në të vërtetë, e vetmja depozitë që përputhet me dëshminë e dëshmitarit është ajo prej 600 Eurosh e bërë dy vjet më parë. Kjo çështje nuk mund të qartësohej sepse gruaja e të pandehurit vendosi të mos ofronte prova, sipas të drejtës së saj nën Nenin 160 (1)1) të KPPK-së, që e përjashton një bashkëshort nga detyra e dhënies së dëshmisë.

⁴Avokati mbrojtës i referohet po ashtu edhe një deklarate të BK, por asnjë deklaratë e tillë nuk është marrë në konsideratë nga Gjykata e Shkallës së Parë në aktgjykimin e saj.

41. Gjykata e Shkallës së Parë i adreson këto kontradikta në aktgjykimin e saj dhe ofron teori të ndryshme shpjeguese se përse nuk ka pasur të dhëna në Uestern Union; pse nuk ka pasur të dhëna lidhur me depozitimin e parave në llogarinë bankare të gruas së të pandehurit; dhe se përse NZ ka thënë 2000 Euro në vend të 500 Eurove; të gjitha këto duke i dhënë përfitimin e dyshimit prokurorisë. Gjykata e Shkallës së Parë ka deklaruar: 'Në kontekstin kontradiktor, sipas mendimit të trupit gjykues ajo që vlen është dëshmia e fuqishme dhe solide e BK lidhur me faktin që paratë i janë dhënë një oficeri policie për të zgjidhur çështjen e pronës. Kjo pjesë e dëshmisë është e qëndrueshme dhe e qartë.' (*Shih Aktgjykimin, faqe nr. 26.*)
42. Kolegji i Gjykatës së Shkallës së Dytë beson se ky vlerësim përfaqëson një përcaktim të gabuar të gjendjes faktike, sipas Nenit 405 (1), (2) të KPPK-së. Trupi gjykues nuk është në gjendje të pranojë përfundimin e Gjykatës së Shkallës së Parë që i pandehuri ka marrë një rryshfet ndërkohë që dëshmia e dëshmitarit ankimues doli që ishte tërësisht e rreme në aspektin material: si për mënyrën se si u transferuan paratë dhe kujt iu transferuan ato. Dëshmia e BZ në këtë drejtim ishte tërësisht e qartë në këtë drejtim, pavarësisht se dëshmia e tij doli e rreme sepse nuk pati asnjë transferim parash përmes Uestern Unionit në llogarinë bankare të gruas së të pandehurit dhe se nuk ka pasur depozitim parash në llogarinë e saj bankare me anë të ndonjë mjeti tjetër gjatë periudhës kohore në fjalë. Për më tepër, nuk ka asnjë lloj prove që ndonjë shumë parash është pranuar në fakt apo është marrë nga vetë i pandehuri.
43. Prandaj, Gjykata e Shkallës së Parë nuk i kushtoi vëmendjen e duhur Nenit 3 (2) të KPPK-së, që siguron si në vijim: '[d]yshimet lidhur me ekzistencën e fakteve relevante në çështje ...do të interpretohen në favor të të pandehurit...' Këtu, të gjitha dyshimet u zgjidhën në favor të prokurorisë. Përshtatshmërisht, aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë lidhur me dënimin për Pikën 5 duhet të modifikohet dhe i pandehuri duhet të lirohet për mungesë provash.

44. Duke pasur parasysh rezultatin e mësipërm, trupi gjykues e sheh të nevojshme adresimin edhe të disa argumenteve të tjera të ngritura nga avokati mbrojtës lidhur me këtë Pikë.

E. PIKA 9: Keqtrajtimi gjatë Ushtrimit të Detyrave.

45. Herën tjetër avokati mbrojtës sulmon Pikën 9, nën të cilën i pandehuri u shpall fajtor për Keqtrajtimin gjatë Ushtrimit të Detyrave, nën Nenin 164 (1) të KPK-së, që mban mbi vete një ndëshkim prej tri (3) muajsh e deri në tri (3) vjet burgim. Kjo Pikë u riklasifikua nga Gjykata e Shkallës së Parë, nga një vepër nën Nenin 339 (1), Abuzimi i Pozitës Zyrtare apo Autoritetit, që mban mbi vete një ndëshkim deri në një (1) vit. Avokati mbrojtës debaton se riklasifikimi përbën një shkelje të Nenit 403 (1) 10) të KPPK-së, sepse shkon në dëm të pandehurit dhe për këtë arsye e tejkalon fushën e akuzës fillestare.
46. Mundësia e rikualifikimit të Pikës 9 doli fillimisht gjatë gjykimit kryesor, kur më 1 prill 2011, kryetari i trupi gjykues i informoi palët lidhur me 'mundësinë abstrakte' që Pika 9 duhet të riklasifikohet nën Nenin 164 (1) të KPK-së. (*Shih* procesverbalin e gjykimit kryesor, të datës 1 prill 2011, faqe nr. 32). Avokati mbrojtës kundërshtoi dhe kërkoi që në rastin e riklasifikimit, mbrojtja duhet të merrte një aktakuzë të ndryshuar dhe do të kishte nevojë për më shumë kohë për të paraqitur mbrojtjen e saj lidhur me këtë.
47. Gjatë seancës së rradhës në gjykimin kryesor, asaj të datës 5 prill 2011, prokurori dhe avokati mbrojtës paraqitën fjalët e tyre përfundimtare. Kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk iu referua më mundësisë së riklasifikimit të Pikës 9. Për më tepër, prokurori dhe avokati mbrojtës, që të dy i paraqitën fjalët përfundimtare lidhur vetëm me Nenin 339 (1) të KPK-së, akuzës fillestare, dhe jo veprës më të rëndë nën Nenin 164 (1), sipas së cilës u dënua i pandehuri.

48. Lidhur me faktin që avokati mbrojtës u mbështet në Nenin 403 (1) 10) të KPPK-së, trupi gjykues vë re se Neni 403 (1) 10) i bën edhe një referencë tjetër Neni 386 (1), dhe si i tillë, flet për **aktin e akuzuar**. Prandaj duhet bërë një dallim mes **aktit të akuzuar** dhe **klasifikimit ligjor të aktit të akuzuar**. Lidhur me të parin – aktin e akuzuar – Neni 386 (1) kërkon që ‘aktgjykimi mund të lidhet vetëm ... me një akt që është edhe subjekti i akuzës që përmban aktakuza’. Ndërsa, për të fundit – klasifikimin ligjor të aktit të akuzuar – Neni 386 (2) siguron që gjykata nuk do të jetë e detyruar nga klasifikimi ligjor që i bën aktit prokurori. Pavarësisht se KPPK-ja nuk i kufizon kompetencat e gjykatës në mënyrë eksplicite për të rikualifikuar një vepër penale nga një vepër me një ndëshkim më të vogël në një tjetër me një ndëshkim më të madh, shumica e trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Dytë beson se argument i avokatit mbrojtës është i bazuar në praktikën ligjore vendase, meqë një riklasifikim i tillë shkon në dëm të të pandehurit.

49. Përveç kësaj, trupi gjykues vë re se elementet e një vepre nën Nenin 339 (1) të KPK-së, Shpërdorimi i Pozitës Zyrtare apo Autoritetit, janë të ndryshme nga ato nën Nenin 164 (1). Pjesa relevante në Nenin 339 (1) lexon:

‘Një person zyrtar i cili, me qëllimin ... për t’i shkaktuar ndonjë dëm një personi tjetër ... shpërdoron ... pozicionin e tij zyrtar, i tejkalon kufijtë e ... autorizimeve të tij apo që nuk i ekzekuton ... detyrat e tij zyrtare do të ndëshkohet...’

Neni 339 (1) nuk kërkon që në fakt personit tjetër t’i shkaktohet dëm aktual duke shpërdoruar pozicionin e tij zyrtar. Vepra penale përfundohet sapo një person zyrtar ‘me **qëllimin** ... t’i shkaktojë dëme personit tjetër shpërdororn pozicionin e tij zyrtar [*vihet theksi*].

50. Kjo është e ndryshme nga Neni 164 (1), që lexon:

‘Një person zyrtar, i cili, gjatë ushtrimit të ... detyrave të tij, **keqtrajton, frikëson ose fyen** një person tjetër, do të ndëshkohet...’ [vihat theksi]

Prandaj, Neni 164 (1) kërkon që prokuroria të përcaktojë që një person tjetër ka vuajtur një dëm aktual, p.sh, keqtrajtimit, frikësimit ose fyerjen. Ky është një element shtesë i cili nuk kërkohet sipas Nenit 339 (1). Duke pasur parasysh faktin që elementët e dy veprave janë të ndryshme, trupi gjykues është i mendimit që Gjykata e Shkallës së Parë duhet t’i kishte dhënë të pandehurit një mundësi për të përgatitur mbrojtjen sipas akuzës së re në një mënyrë të efektshme, sipas Nenit 12 (1) të KPPK-së, që thotë se ‘[i]pandehuri do të ketë të drejtën që të ketë kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur ... mbrojtjen e tij’. Megjithatë, materiali që gjendet përpara trupit gjykues tregon që të pandehurit nuk i është dhënë ndonjë mundësi për të përgatitur mbrojtjen e tij për akuzën nën Nenin 164 (1) të KPK-së, sepse ai ka mësuar vetëm përmes aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për dënimin për veprën penale nën Nenin 164 (1).

51. Kjo ka çuar në një shkelje substanciale të procedurës penale sipas Nenit 403 (2) 2) të KPPK-së. Megjithatë, një rigjykim nuk është i nevojshëm. E vetmja arsye që Gjykata e Shkallës së Parë e dënoi të pandehurin për veprën penale sipas Nenit 164 (1) të KPK-së, dhe jo sipas akuzës nën Nenin 339 (1), është për shkak të mendimit të saj se Neni 339 (1) kërkon një përfitim material ose dëm **material**. Trupi gjykues nuk pajtohet me këtë argument të Gjykatës së Shkallës së Parë që termi ‘dëm’ në Nenin 339 (1) mbulon vetëm ‘dëmin material’.⁵ Neni 339 (1) i referohet qartë ‘**çdo dëmi**’. Termi ‘çdo dëm’ përfaqëson si dëmin material ashtu edhe dëmin jomaterial, të tillë si, dhimbjen fizike, format e ndryshme të shqetësimeve emocionale, frikën dhe përkeqësimin e aparencez fizike.
52. Një lexim i tillë i Nenit 339 (1) është nënvizuar edhe në paragrafin pasues të së njëjtës dispozitë, Neni 339 (2), që lexon: ‘Kur vepra penale për të cilën flitet në paragrafin 1 ...

⁵ Neni 339 (1) i KPK-së lexon: ‘Një person zyrtar që **me qëllimin** për të marrë një përfitim material për veten e tij ose të saj, ose për ndonjë person tjetër apo organizatë biznesi ose **për të shkaktuar ndonjë dëm ndaj një personi tjetër** apo organizatë biznesi, shpërdoron pozicionin e tij apo të saj zyrtar, i tejkalon kufijtë e autorizimeve të tij apo të saj apo nuk i ekzekuton detyrat e tij apo të saj zyrtare do të ndëshkohet me burgim deri në një vit.’

rezulton në një dëm që e tejkalon shumë prej 2500 EUR **ose përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të një personi tjetër**, kryesi i veprës penale do të ndëshkohet...'

53. Prandaj, është e dukshme që ligjvënësi ka synuar që sipas Nenit 339 (1), kryesi i veprës penale mund të veprojë me qëllimin për të shkaktuar dëme material ndaj një personi tjetër, ashtu si edhe me qëllimin për të shkaktuar dëme jomateriale ndaj personit tjetër. Nëse Neni 339 (1) synonte të mbulonte vetëm dëmin material ndaj një personi tjetër, ligjvënësi nuk do të kishte përdorur fjalët '**çdo dëm**' në Nenin 339 (1). Për më tepër, përveç dëmit material që e tejkalon shumë prej 2500 EUR ligjvënësi nuk do të kishte përfshirë një dëm alternative të '**shkeljes së rëndë të të drejtave të personit tjetër**' në Nenin 339 (2).
54. Për më tepër, trupi gjykues vë re se aty ku në KPK ligjvënësi synonte të mbulonte vetëm dëmin material, e ka specifikuar atë në mënyrë ekspresive duke përfshirë fjalët 'dëmi material'. Duke marrë një shembull, trupi gjykues i referohet Veprimtarive të Papërgjegjshme Ekonomike, Neni 233 (1) i KPK-së, dhe Organizimit të Skemave Piramidale, si edhe Bixhoz i Paligjshëm, Neni 243 (3) i KPK-së.
55. Duke pasur këtë parasysh, trupi gjykues nuk e sheh të arsyeshme që ta kthejë çështjen për rigjykim, sepse provat janë të mjaftueshme për të mbështetur dënimin e të pandehurit për akuzën fillestare të Shpërdorimit të Pozicionit Zyrtar apo Autoritetit, nën Nenin 339 (1) të KPK-së. Gjykata e Shkallës së Parë ka përcaktuar se që nga viti 2006 e deri në vitin 2009, në Stacionin e Policisë në Obiliq, në pozicionin e tij të komandantit të stacionit të policisë, e prandaj në kapacitetin e personit zyrtar, i pandehuri ka keqtrajtuar dhe ka fyer KH, oficerë policie në stacionin e mësipërm, duke i thënë asaj në disa raste 'ti nuk vlen fare, ti nuk di të ecësh, je një gjë e qelbur'.
56. Nëpërmjet kësaj sjelljeje i pandehuri ka shpërdoruar pozicionin e tij zyrtar me qëllimin e dukshëm për t'i shkaktuar dëme psikologjike KH. Kjo mbështetet edhe nga provat të cilat demonstrojnë që shëndeti mendor i KH ishte ndikuar në mënyrë të pafavorshme nga

sjellja e të pandehurit. KH kaloi në një 'gjendje të rëndë shëndetësore' dhe pësoi 'një krizë nervore' të cilat bënë që ajo të shkonte në spital në urgjencë dhe rrjedhimisht, iu desh të bënte seanca këshillimi psikologjik. (Shih procesverbalin e gjykimit kryesor të datës 21 tetor 2010, faqet nr. 21, 25.)

57. Prandaj, trupi gjykues, arrin në përfundimin që përmes aplikimit të saktë të ligjit, Nenit 12 (1), 403 (2) 2) të KPPK-së, Nenit 339 (2) të KPK-së, me qëllim që të përmirësohet shkelja substanciale e procedurës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë, dënimi i të pandehurit për Pikën 9 është riklasifikuar në akuzën fillestare – Shpërdorimi i Pozicionit Zyrtar apo Autoritetit, Neni 339 (1) i KPK-së, sepse që nga viti 2006 e deri në vitin 2009, në Stacionin e Policisë në Obiliq, i pandehuri ka shpërdoruar pozicionin e tij zyrtar të komandantit të stacionit të policisë në Obiliq, me qëllimin për t'i shkaktuar dëme psikologjike KH, oficerë policie në stacionin e mësipërm, duke i thënë asaj në disa raste 'ti nuk ke vlerë, ti nuk di të ecësh, je vetëm një gjë e qelbur'.

F. PIKA 10: Keqtrajtimi në Ushtrimin e Detyrave.

58. Avokati mbrojtës debaton po ashtu se fjalët e përdorura kundër dëshmitarit ankues në Pikat 9 dhe 10, edhe po të provohet, nuk përbëjnë shkelje nën Nenin Art 164 (1) të KPK-së, Keqtrajtimi gjatë Ushtrimit të Detyrave. Megjithatë, trupi gjykues e ka riklasifikuar tani Pikën 9 në një shkelje që bie nën Nenin 339 (2), pra për qëllimet e këtij argumenti trupi gjykues do t'i referohet vetëm Pikës 10.
59. Sa për Pikën 10, Gjykata e Shkallës së Parë ka arritur në përfundimin se i pandehuri ka keqtrajtuar, frikësuar dhe fyer KB, një anëtare të publikut, e cila shkoi drejtë e në prokurori me një ankesë lidhur me mënyrën se si e kishte trajtuar policia çështjen e saj. I pandehuri i ka thënë KB: 'A e di se për sa kohë të jem unë këtu, ti nuk do të guxosh të shkosh në ndonjë vend tjetër? Sigurisht, ti nuk je normale. A e di që unë mund të të

paraburgos?’ Avokati mbrojtës debaton që këto fjalë, edhe po të provohen, nuk përbëjnë ndonjë shkelje sipas Nenit 164 (1) të KPK-së.

60. Trupi gjykues e hedh poshtë atë argument të avokatit mbrojtës dhe pajtohet me rezultatet e Gjykatës së Shkallës së Parë. Neni 164 (1) siguron që ‘[n]jë person zyrtar, i cili, gjatë ushtrimit të ... detyrave të tij apo të saj zyrtare, keqtrajton, frikëson apo fyen një person tjetër, do të ndëshkohet...’ Fjalët që i pandehuri i ka thënë KB, një anëtareje të publikut, mund të përshkruhen vetëm si fyese dhe frikësuese. Rrjedhimisht, ky argument i avokatit mbrojtjes nuk ka meritë.
61. Për më tepër, avokati mbrojtës debaton që Gjykata e Shkallës së Parë duhet ta kishte lejuar mbrojtjen të merrte prova lidhur me gjoja një raport të fallsifikuar të dorëzuar nga KB, i cili aludonte që KB kishte qenë subjekt i një tentative rrëmbimi dhe përdhunimi nga një grup personash të maskuar në nëntor të vitit 2009, që supozohet ishte bërë me kërkesën e të pandehurit.
62. Çështja u ngrit më së pari gjatë marrjes në pyetje nga pala e kundërt të KB, gjatë së cilës ajo pranoi t’i kishte dhënë një deklaratë policisë. KB është pyetur më pas nëse ka pasur ndonjë kallëzim penal dhe ndonjë hetim kundër saj për bërjen e një raporti të fallsifikuar. Ajo deklaroi që nuk kishte dijeni për një hetim të tillë dhe pastaj vazhdimi i pyetjeve lidhur me këtë temë nuk u vazhdua. (*Shih* proçesverbalin e gjykimit kryesor të datës 21 tetor 2010, faqet nr. 35-37.)
63. Çështja u adresua përsëri më datën 21 janar 2011, kur kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë, nuk e aprovoi kërkesën e mbrojtjes për të marrë prova që lidhen me proçedurën penale ndaj KB, për bërjen e nja raporti të fallsifikuar, mbi bazën që provat nuk kishin lidhje me gjykimin kryesor dhe prandaj ato nuk ishin relevante.

64. Gjykata e Shkallës së Parë ka vepruar mirë brenda autoritetit të saj për të refuzuar aplikimin mbi bazën e relevancës dhe vlerës probative, meqë incidenti i gjoja raportit të fallsifikuar ka ndodhur shumë kohë pas ngritjes së akuzës përkatëse në aktakuzë dhe nuk ka pasur të bëjë fare me akuzën. Neni 152 (2) i KPPK-së siguron që 'gjykata sipas vlerësimit të saj mund të pranojë dhe të marrë në konsideratë çdo provë të pranueshme që i duket relevante dhe ka vlerë probative lidhur me procedurën penale të veçantë...'
65. Në seancën përpara Gjykatës së Shkallës së Dytë, i pandehuri dorëzoi një dokument, të datës 2 nëntor 2009, që gjoja finalizon hetimin nga stacioni i policisë në Obiliq ndaj raportit të fallsifikuar të bërë nga KB. Dokumenti arrin në përfundimin që rasti nuk ka ndodhur, që KB 'e ka teatralizuar' ankesën dhe se ajo ka dijeni që ka kryer një vepër penale. Megjithatë, dokumenti nuk është i nënshkruar, dhe as që ka emër të autorit të tij në të. Rrjedhimisht, trupi gjykues nuk është në gjendje t'i falë besimin këtij dokumenti apo ta pranojë atë si provë.

G. Argumentet e tjera në Ankesë.

66. Gjykata e Shkallës së Dytë do të adresojë tani argumentet e natyrës më të përgjithshme të avokatit mbrojtës.
67. Avokati mbrojtës tregon se kallëzimi penal në lëndë është dorëzuar pa ndonjë hetim dhe se aktakuza është dorëzuar brenda tri (3) ditësh pa kryerjen e ndonjë hetimi. Ai deklaron se një procedurë e tillë shkel Nenin 304 (1) të KPPK-së. Megjithatë, trupi gjykues konkludon se fjalët e saktë të Nenit 304 (1) thonë të kundërtën: 'Pas përfundimit të hetimit, **ose nëse prokurori publik konsideron që informacioni që ka lidhur me një vepër penale dhe me kryesin sigurojnë baza të mjaftueshme për ngritjen e një aktakuze, procedura përpara gjykatës mund të kryhet vetëm mbi bazën e një aktakuze të ngritur nga prokurori publik.**'

68. Prandaj, Neni 304 (1) paraqet dy mënyra të ndryshme me anë të të cilave mund të dorëzohet aktakuza: pas hetimit, ose kur prokurori beson që ai/ajo ka të dhëna të mjaftueshme për ta bërë një gjë të tillë, edhe pa një hetim. Në rastin aktual, prokurori ka zgjedhur rrugën e fundit, duke u bazuar mbi deklaratat e ndryshme nga dëshmitarët ankues, të mbledhura nga policia. Rrjedhimisht, trupi gjykues nuk sheh ndonjë shkelje dhe e hedh poshtë argumentin e avokatit mbrojtës.
69. Për më tepër, edhe nëse proçedura do të quhej disi si një shkelje e proçedurës penale, ajo nuk do të përbënte një shkelje substanciale. Sipas Nenit 403 (2) të KPPK-së, një shkelje e proçedurës është substanciale vetëm, nëse gjykata e ka aplikuar atë gabimisht 'dhe kjo [shkelje] ka ndikuar ose mund të kishte ndikuar dorëzimin e një aktgjykimi të ligjshëm e të duhur'. Avokati mbrojtës debaton se prokurori ka nxituar në gjykimin e tij pa bërë vlerësimin e kujdesshëm të lëndës dhe se kjo mungesë vlerësimi ka pasur një efekt të kundërt në të gjithë gjykimin. Megjithatë, Gjykata e Shkallës së Parë ka kryer një gjykim kryesor të gjatë e të hollësishëm dhe ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat, kështu që trupi gjykues nuk është në gjendje të shohë ndonjë shkelje, e le pastaj ndonjë shkelje substanciale.
70. Po ashtu debatohet nga avokati mbrojtës se kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë e ka shkelur proçedurën penale duke pranuar si provë provat e ofruara nga MP (Pikat 1) dhe KB (Pika 10) në fillim të gjykimit kryesor dhe jo në kohën e duhur gjatë marrjes së dëshmisë së tyre apo gjatë fazës së administrimit të provave materiale. Këto prova konsistojnë në dokumente të shumta, shumica e të cilave ishin dokumente mjekësore dhe që ishin pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë në fillim të gjykimit kryesor, pas kundërshtimeve të avokatit mbrojtës. Megjithatë, edhe nëse kjo do të ishte quajtur si një shkelje e proçedurës penale, është e vështirë të shihet se si 'ka ndikuar ose mund të kishte ndikuar dorëzimin e një aktgjykimi të ligjshëm e të duhur', sipas Nenit 403 (2) të KPPK-së. Prandaj, kjo nuk ka përbërë një shkelje substanciale të proçedurës penale.

71. Një argument tjetër thotë që Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur procedurën penale duke lejuar palët e lënduara, si dëshmitarë, të qëndrojnë në sallën e gjykimit gjatë dhënies së dëshmisë së palës tjetër të lënduar, në kundërshtim me Nenin 164 (1) të KPPK-së, sipas të cilit 'dëshmitari duhet të merret në pyetje veçmas dhe pa praninë e dëshmitarëve të tjerë'. Gjykata e Shkallës së Parë e diskuton këtë çështje në aktgjykimin e saj, në faqen nr. 36. Si një çështje faktike, Gjykata e Shkallës së Parë thekson se palët e lënduara, në fakt, janë larguar nga salla e gjykimit më datën 18 tetor 2010, në ditën e parë të gjykimit. (*Shih* proçesverbalin e gjykimit kryesor, faqe nr. 11. Është shënuar: 'Palët e lënduara, pavarësisht se janë lejuar të qëndrojnë, vendosën të dalin nga salla e gjykimit.') Nga proçesverbali nuk është e qartë nëse palët e lënduara ishin në sallën e gjykimit në ditët e tjera gjatë dëshmive, por ato duhet të kenë qenë të pranishme, meqë Gjykata e Shkallës së Parë e ka trajtuar këtë çështje edhe në aktgjykimin e saj.
72. Gjykata e Shkallës së Parë në aktgjykimin e saj thekson dispozitën e Nenit 361 (1) të KPPK-së, që thotë se 'një dëshmitar i cili nuk ka dëshmuar, si rregull, nuk do të lejohet ta marrë pjesë në paraqitjen e provave'. Gjykata e Shkallës së Parë në aktgjykimin e saj shpjegon se fjalët 'si rregull' në Nenin 361 (1) 'e bëjnë të qartë se kjo dispozitë nuk është e detyrueshme dhe që mund të shpërfillet në varësi të rrethanave'. Gjykata e Shkallës së Parë e arsyeton më tej që një palë e lënduar, po ashtu, gëzon të drejtën t'i drejtojë pyetje dëshmitarëve dhe të komentojë lidhur me provat, sipas Nenit 80 (3) të KPPK-së, dhe prandaj ajo gëzon të drejtën të jetë e pranishme në sallën e gjykimit, 'ndryshe të drejtat e tij/të saj të parapara me anë të Nenit 80 mund të mohohen në mënyrë të paligjshme' (*Shih* Aktgjykimin, faqe nr. 36).
73. Megjithatë, edhe nëse Gjykata e Shkallës së Parë e ka keqinterpretuar Nenin 361 (1), nuk ka pasur shkelje substanciale të procedurës penale sipas rrethanave të kësaj çështjeje. Kjo, për shkak se secila palë e lënduar ka dëshmuar lidhur me një incident të veçantë e të veçuar që nuk e ka përfshirë palën tjetër të lënduar. Prandaj, mundësia e ndikimit të dëshmitarit ishte minimizuar. Me fjalë të tjera, dëshmia e njëres palë të lënduar nuk

mund të ndikonte në dëshminë e palës tjetër të lënduar, sepse gjendja faktike e tyre ishte tërësisht e ndryshme. Rrjedhimisht, edhe nëse ka ekzistuar ndonjë shkelje procedurale, ajo nuk ka pasur ndonjë mundësi të kishte ndonjë efekt të kundërt në dhënien e aktgjykimit.

74. Po ashtu, ka edhe një çështje më të gjerë që kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë, ka treguar anshmëri ndaj të pandehurit. Kjo deklaratë e gjerë përmbledh edhe deklarata më specifike, të tilla si, kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë mori përsipër rolin e prokurorit në pyetjet e tij, që e ka çuar dëshmitarin drejt inkriminimit të të pandehurit përmes pyetjeve sugjestive dhe që e ka keqtrajtuar avokatin mbrojtës.
75. Është e vërtetë që kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë e ka marrë përsipër marrjen në pyetje në shumë raste, dhe se ai ka qenë një person që ka bërë pyetje të tërësishme dhe të vigoroze. Është, po ashtu, e vërtetë që kryetari i trupit gjykues dhe avokati mbrojtës zhvilluan një marrëdhënie mjaft të mjerë gjatë gjykimit kryesor. Është e pamohueshme që gjatë gjykimit kryesor, herë pas here, kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë, ka qenë i ashpër dhe me temperament me avokatin mbrojtës. Proçesverbalet e gjykimit kryesor shënojnë se kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë i ka trajtuar disa deklarata të avokatit mbrojtës si fyese.
76. Trupi gjykues i Gjykatës së Shkallës së Dytë përkujton që paanshmëria personale e një gjyqtari duhet ruajtur deri atëherë kur ka prova që provojnë të kundërtën (GJEDNJ, Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July v. Francës, 22 tetor 2007, par. 76). Duke u kthyer në rastin konkret, një marrje në pyetje e hollësishme e dëshmitarit nga ana e kryetarit të trupit gjykues, mund të mos merret si një demonstrim i anshmërisë nga ana e kryetarit të trupit gjykues. Në fakt, pyetjet tregojnë se kryetari i trupit gjykues kërkoi të qartësonte në detaje aludimet e prokurorisë ndaj të pandehurit.

77. Edhe pse kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë në disa raste e ka qortuar avokatin mbrojtës, ai nuk ka vënë ndonjë kufizim të rëndësishëm lidhur me mundësinë e avokatit mbrojtës për të paraqitur mbrojtjen e tij ose që ai të sfidonte qëndrimin e prokurorit. Ndërkohë që në procedurat gjyqësore pritet një qasje e veçantë (*Shih GJEDNJ, Kyprianou v. Qipros*, 15 dhjetor 2005, par. 130, 131), deklaratat gjyqësore të bëra gjatë gjykimit kryesor dhe arsyetimi i dhënë në aktgjykim, nuk demonstrojnë që kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Shkallës së Parë apo trupi gjykues i saj janë ndikuar nga ndonjë paragjykim personal.
78. Një rishikim i kujdesshëm i aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, tregon se kryetari i trupit gjykues dhe trupi gjykues i kanë trajtuar provat në mënyrë objektive dhe të tërësishme, dhe se kanë shpallur një aktgjykim në përputhje me to dhe pa anshmëri. Në të vërtetë, duhet vënë re se i pandehuri është liruar si nga Pika 2 edhe nga ajo 7 dhe se ai është shpallur fajtor për një vepër penale më të vogël se ajo në Pikën 3. Prandaj, argumentet e avokatit mbrojtës hidhen poshtë.
79. Argumentet e mbetura mund të grupohen së bashku dhe faktikisht ato thonë që ka pasur paqëndrueshmëri në dëshmitë e dëshmitarëve, si brenda tyre ashtu edhe më njëra-tjetrën; që ka pasur paqëndrueshmëri mes deklaratave të dhëna nga dëshmitarët gjatë gjykimit kryesor dhe deklaratave të tyre me shkrim; që aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk ka pasur ndonjë shtjellim të dëshmimeve të dëshmitarëve, të cilat ishin në favor të të pandehurit; dhe se trupi gjykues i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk i ka dhënë ndonjë besim shpjegimeve të të pandehurit lidhur me motivet e mundshme të dëshmitarëve ankues apo të fjalës përfundimtare të avokatit mbrojtës. Tema qendrore e të pandehurit në të gjitha këto argumente është që dëshmitarët ankues kanë konspiruar kundër tij si hakmarrje mbi disa vendime të caktuara menaxheriale që ai ka bërë dhe që kanë qenë të pafavorshme ndaj dëshmitarëve ankues dhe se aim und të ketë qenë përgjegjës lidhur me arrestimin e një prej të afërmeve të njërit prej tyre.

80. Këto argumente kundërshtohen nga një analizë e hollësishme e ndërmarrë nga Gjykata e Shkallës së Parë lidhur me secilën pikë të aktakuzës, siç reflektohet qartësisht në aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata e Shkallës së Parë i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat, si ato në favor të prokurorisë, ashtu edhe ato në favor të të pandehurit, duke përfshirë këtu edhe deklaratat e vetë të pandehurit, dhe duke shpjeguar në detaje të hollësishme se si ka arritur në përfundimet e saj.
81. Trupi gjykues i Gjykatës së Shkallës së Dytë nuk sheh ndonjë vërtetim të gabuar apo të paplotë të gjendjes faktike (përveç diskutimeve të mësipërme lidhur me Pikën 5). Me të vërtetë, argumentet e avokatit mbrojtës karakterizohen më së miri si mospajtim i tij me rezultatin, se sa si një pamjaftueshmëri legjitime nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për të vlerësuar provat dhe përcaktuar faktet.
82. Duke marrë parasysh sa më sipër, pjesa e mbetur e ankesës së avokatit mbrojtës hidhet poshtë, si e pabazuar, sipas Nenit 420 2) të KPPK-së.

H. Dënimi.

83. Gjykata e Shkallës së Parë ka përcaktuar dënimin e përgjithshëm prej tridhjetë e tetë (38) muajsh burgim, me dënimin unik prej dy (2) vjetësh e katër (4) muajsh burgim, duke përllogaritur kohën e shpenzuar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, që nga data 27 gusht 2009 e deri më 5 janar 2010. Gjykata e Shkallës së Dytë e ka anuluar tashmë dënimin për Pikën 1, për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit, dhe për këtë vepër penale i pandehuri është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë me gjashtë (6) muaj burgim; dhe gjykata ka anuluar, po ashtu, edhe dënimin për Pikën 5, për shkak të provave të pamjaftueshme dhe për këtë vepër penale i pandehuri është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim. Dënimet për Pikën 1 dhe Pikën 5, që në total përbëjnë njëzet e katër (24) muaj, duhen zbritur nga dënimi i përgjithshëm

prej tridhjetë e tetë (38) muajsh, duke numëruar dënimin e ri prej katërbëdhjetë (14) muajsh.

84. Ndërsa trupi gjykues i Gjykatës së Shkallës së Dytë e ka riklasifikuar Pikën 9 në një vepër penale nën Nenin 339 (1) të KPK-së, që mban mbi vete një dënim më të vogël se maksimumi se sa ai nën Nenin 164 (1), sipas të cilit i pandehuri u dënua nga Gjykata e Shkallës së Parë, trupi gjykues nuk e sheh të justifikuar t'i largohet dënimit me burgim prej gjashtë (6) muajsh dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë. Trupi gjykues konsideron se dënimi është me vend sipas Nenit 64 (1) të KPK-së, duke pasur parasysh rrethanat rënduese, siç janë përcaktuar në aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë – që i pandehuri e ka kryer veprën penale duke qenë komandant i Stacionit të Policisë së Obiliqit, duke përfituar nga pozicioni i tij i pushtetit në stacion, jo vetëm në një rast, por k a treguar tendencë të përsëritjes së një veprimi të tillë.
85. Trupi gjykues pajtohet me vendimin mbi dënimin të Gjykatës së Shkallës së Parë lidhur me Pikat 3 dhe 10. Por duke pasur parasysh një zbritje të konsiderueshme të dënimit të përgjithshëm – anulimin e dënimit për Pikën 1, lirimn nga Pika 5 dhe riklasifikimin e Pikës 9 në një vepër penale me dënim më të ulët – dënimi shtesë i ndalimit të ushtrimit të detyrave të administratës publike apo shërbimit public, do të zbritet për Pikat 3, 9 dhe 10 nga tri (3) vjet në dy (2) vjet pas vuajtjes së dënimit.
86. Gjatë modifikimit të aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë lidhur me dënimin shtesë, trupi gjykues i referohet Nenit 64 (1) të KPK-së. Dënimi shtesë (ndihmës) prej dy (2) vjetësh konsiderohet të jetë proporcional me sjelljen kriminale të të pandehurit, siç është përcaktuar nga trupi gjykues në këtë vendim. Ai mjaftueshmërisht shërben për të parandaluar të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe për rehabilitimin e tij. Për më tepër, dënimi dërgon një mesazh të fuqishëm tek të gjithë ata që mbajnë poste autoritative, që kur përfiton nga autoriteti, ajo nuk do të tolerohet. Pozicioni i autoritetit nuk është një privilegj për përfitimin personal të dikujt, por në të

kundërt, ai vendos një përgjegjësi shtesë për të siguruar funksionimin e zyrës në pajtim të plotë me ligjin.

87. Rrjedhimisht, i pandehuri dënohet si në vijim:

Pika 3, Tentativë për Abuzim Seksual duke Shpërdoruar Pozicionin, Autoritetin ose Profesionin, Nenet Art 20, 200 (2) 1) të KPK-së - katër (4) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave të administratës publike apo shërbimit publik për dy (2) vjet;

Pika 9, Shpërdorimi i Pozicionit Zyrtar apo Autoritetit, Neni 339 (1) i KPK-së – gjashtë (6) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave të administratës publike apo shërbimit publik për dy (2) vjet;

Pika 10, Keqtrajtimit gjatë Ushtrimit të Detyrave, Neni 164 (1) i KPK-së - katër (4) muaj burgim me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të detyrave të administratës publike apo shërbimit publik për dy (2) vjet;

88. Dënimi i përgjithshëm prej katërmbëdhjetë (14) muajsh burgim zbritet në dymbëdhjetë (12) muaj burgim, (dënimi unik) duke përlloritur kohën që i pandehuri ka kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, që nga data 27 gusht 2009 e deri më datën 5 janar 2010.

Kryetari i Trupit Gjykses:

Gjyqtari i EULEX-it Dean Pineles

Proçesmbajtës:

Anëtarët e Trupit Gjykses:

Zyrtarja Ligjore e EULEX-it
Zane Ratniece

Gjyqtari Rafet Haxhaj

Gjyqtari Vehbi Kashtanjeva